

Njoftim
Për zhvillimin e testimit për vlerësues dëmsh në sigurime

Në zbatim të nenit 227, pika 1, shkronja dh), dhe pika 3, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, dhe të nenit 7 të Rregullores nr. 35, datë 27.03.2019, “Mbi organizimin dhe funksionimin e testimit të njohurive të kandidatëve që aplikojnë për licencë/rinovim licence në AMF”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) njofton të gjithë të interesuarit se:

Më datë 07.04.2026 do të zhvillohet testimi për licencim ose rinovim të licencës së vlerësuesve të dëmeve në sigurime.

Në testim do të marrin pjesë të interesuarit që aplikojnë për tu pajisur me licencën e vlerësuesit të dëmeve në sigurime, profesionistë që janë të interesuar për rinovim licence si dhe ata që kanë marrë vlerësime negative në testimet e mëparshme, në përputhje me nenin 13 të Rregullores nr. 35, datë 27.03.2019.

Për të marrë pjesë në testim të interesuarit duhet të përmbushin të gjitha kërkesat e Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, si dhe të Rregullores nr. 85, datë 03.07.2017, “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, e ndryshuar.

Shpallja e Listës së personave që do t’i nënshtrohen testimit të njohurive, do të publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike nga data e zhvillimit të testimit.

Për detaje lidhur me orën dhe vendin ku do të zhvillohet testimi, aplikantët do të njoftohen individualisht, sipas përcaktimeve në Rregulloren nr. 35, datë 27.03.2019.

Për më shumë informacion, ju lutem kontaktoni: amf@amf.gov.al.